



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07
Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Për: **Trupin Gjykesues II**
Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës
Gjykatës Kristof Bart
Gjykatës Ginel Metro
Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Parashtrues: Prokurori i Specializuar
Data: 28 shtator 2021
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Publik

**Parashtrim i listës së përditësuar të provave materiale prej Prokurorisë,
me shtojcën konfidenciale 1**

Zyra e Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit
Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt
Tobi Kadman

I. PARASHTRIM

1. Në përputhje me Vendimin,¹ dhe sikurse paralajmëroi Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS'),² shtojca 1 e këtij parashtrimi përmban listën e përditësuar të provave materiale të ZPS-së. Të vetmet përditësime janë: (i) 29 prova shtesë të cilat Trupi Gjykses, me anë të Vendimit të lartpërmendur, autorizoi ZPS-në t'i përfshinte në listën e provave materiale të saj;³ dhe (ii) heqja e nëntë provave⁴ të cilat ZPS-ja bëri të ditur në Përgjigjen e vet se do t'i hiqte.⁵
2. Shtojca 1 dorëzohet si konfidenciale, në përputhje me klasifikimin aktual të disa prej provave që përmenden në të.⁶

Numri i fjalëve (në origjinal): 324

/nënshkrimi/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

¹ Vendim mbi kërkesën e Prokurorisë për leje për ndryshimin e listës së saj të provave materiale, KSC-BC-2020-07/F00321, 23 shtator 2021 ('Vendimi'), para.39(b).

² *Shih* Përgjigje përmbledhëse e Prokurorisë ndaj kundërshtimeve të Mbrojtjes në lidhje me pranueshmërinë, KSC-BC-2020-07/F00322, 24 shtator 2021 ('Përgjigja e ZPS-së'), para.3, f.6.

³ Vendimi, KSC-BC-2020-07/F00321, para. 18-37, 39(a). 29 provat janë të renditura nën numrat 483 deri në 511 në shtojcën 1.

⁴ 090121-TR-ET Pjesa 1 RED; 090125-TR-ET Pjesa 1 RED; 090125-TR-ET Pjesa 2 RED; 090128-TR-ET Pjesa 1 RED; 090131-TR-ET Pjesa 1 RED; 090134-TR-ET Pjesa 1 RED; 090138-TR-ET Pjesa 1 RED; 090138-TR-ET Pjesa 2 RED; 090141-TR-ET Pjesa 1 RED. Këto prova janë të renditura nën numrat 274 deri në 282 në shtojcën 1 të Parashtrimin të listës së përditësuar të provave materiale, KSC-BC-2020-07/F00254/A01, 6 korrik 2021, konfidenciale ('Lista e provave materiale e 6 korrikut 2021'). Për të mos bërë rinumërtimin e provave materiale në shtojcën 1, ndër të tjera për arsye se në kërkesën e vet për pranimin e provave jोगojore, mbi të cilën ende nuk është marrë vendim, ZPS-ja i referohet numërtimit të provave si në listën e provave materiale të 6 korrikut (*shih* shtojcën 1 të Kërkesës së Prokurorisë për pranimin e provave jोगojore, KSC-BC-2020-07/F00291/A01, 31 gusht 2021, konfidenciale), ZPS-ja ka hequr informacionin për provat e renditura nën numrat 274 deri në 282 në shtojcën 1, por nuk ka fshirë rreshtat që i korrespondojnë atij numërtimi.

⁵ Përgjigja e ZPS-së, KSC-BC-2020-07/F00322, para.3, f.6.

⁶ *Shih* Parashtrime të Prokurorisë lidhur me klasifikimin e provave materiale në kërkesën për pranimin e provave jोगojore, KSC-BC-2020-07/F00298, 6 shtator 2021; Parashtrime në përputhje me urdhrin e tretë gojor të Trupit Gjykses të datës 8 shtator 2021, KSC-BC-2020-07/F00324, 24 shtator 2021.

E martë, 28 shtator 2021

Në Hagë, Holandë